

VENDIM
Nr. 207, datë 6.3.2013

**PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS,
FINANCIMIT DHE PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR
NGA MINISTRIA E FINANCIVE, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PROGRAMI RURAL I
FURNIZIMIT ME UJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 9883, datë 28.2.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i furnizimit me ujë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rishpërndarjes së fondeve sipas marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i furnizimit me ujë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha